



Republika e Kosovës

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja

Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti shërbimeve këshillimore teknike

Department of Technical and Advisory Services

Departmend za tehničke i savjetodavne usluge



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës

Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services

Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

Rëndësia e korrje shirjeve ne afate optimale



Të nderuar fermer

Jemi ne fillim te korrje shirjeve, pasi që jemi në kohën e pjekjes së drithërave të bardha. Nisur nga rëndësia që ka procesi i korrje shirjeve të drithërave të bardha, është mjaftë e rëndësishme që

gjatë kësaj kohe të jeni në kontakt të vazhdueshëm me komisionin për korrije shirje me qëllim të koordinimit sa më të mirë për monitorimin e procesit të korrije shirjeve të drithërave të bardha. Jemi te vetëdijshëm për ndryshimet klimatike që po ndodhin, andaj shfrytëzoni kushtet atmosferike te favorshme dhe aty ku gruri ka arritur pjekjen teknologjike ta bëni korrijen. MBPZHR në bashkëpunim me palët e tjera ka bërë parapërgatitjet për fillimin dhe realizimin e procesit të korrije shirjeve të drithërave për vitin 2024.

Duke marr parasysh ato që u than me lart ne ju ftojmë të mobilizoheni dhe të bashkëpunoni ngushtë me komisionet komunale, që se paku në këtë fazë ti evitohet humbjet e mëtutjeshme në rendiment.

Me qëllim të koordinimit sa më të mirë të punëve, MBPZHR duke u bazuar në përvojat dhe koordinimin e përbashkët dhe të vazhdueshëm në vitet paraprake me drejtorit komunale për bujqësi dhe shoqatën e mullisëve të Kosovës për monitorimin e procesit të korrije shirjeve propozon që edhe këtë vit, njëjtë si viteve të kaluara të vlejë rekomandimet për të gjitha palët që janë të përfshira në këtë proces.

Andaj Shërbimet Këshillimore të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim rural ju ftojnë që të bashkëpunoni ngushtë me komisionet komunale për korrije shirje si dhe me këshilltarët për bujqësi dhe zhvillim rural në komunat tuja që të konsultoheni rreth kohës optimale për korrije shirjen e grurit tuaj.

Pra keni kujdes mos filloni me korrije shirjet para pjekjes së plot të grurit, pasi që do të ketë humbje të grurit dhe ndikim në ulje të rendimentit mesatar, si dhe pikat grumbulluese nuk do të pranojnë grurin nga fermerët nëse lagështia e grurit nuk është brenda normave optimale të lagështisë (12 -13 %).



Ju rekomandohet pikave grumbulluese te grurit qe ti pajisin fermerët me dëshmi për dorëzimin e grurit ne bazë te sasisë se dorëzuar.

Ketë vit, bazuar ne çmimin e tanishëm te derivateve si dhe gjendjes se zhvillimit te grunajave, MBPZHR sugjeron qe çmimi real i korrje shirjeve për vitin 2024 te jetë 130 €/ha, realisht ky është vetëm një propozim, pasi qe çmimi caktohet me marrëveshje mes dy palëve fermer dhe Auto kombajner.

Ku mund te këshilloheni për kohen optimale te korrjes

Nga informatat qe kemi nga tereni përmes këshilltarëve ne Qendrat këshilluese komunale për Bujqësi, përqindja e lagështisë ne disa rajone është akoma e lartë mbi normat optimale 12-13 %, andaj ju rekomandojmë qe te jeni ne kontakt te vazhdueshëm secili ne komunën e vet me këshilltarët komunal.

Pra ju njoftojmë qe mund te drejtoheni ne Qendrat Informative Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, secili ne komunën e vet tek këshilltarët komunal qe koordinohen me **Departamentin për shërbime këshilluese.**

Këshilltaret janë te pajisur me njohuri dhe janë ne kontakt te vazhdueshëm me komisionet komunale për korrje shirjet. Ata do te ju ndihmojnë ne përcaktimin e kohës optimale si dhe informata tjera te nevojshme për ketë proces final dhe mjaft te rëndësishëm te grurit.

Për informata shtesë dhe çdo gjë qe lidhet me këshillat mund te drejtoheni ne:

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, MBPZHR

Rr. "Ukshin Hoti", ndërtesa e ish Ramiz Sadikut, nr 120 Kati III, Prishtinë – Kosova

Tel. 383- (0)3820038426